



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL<sup>1</sup>

*(I përmbledhur)*

Tiranë, më 10.05.2019, ora 12.00

**Drejton mbledhjen**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

- 1. Diskutimi në parim mbi Metodologjinë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese.*
- 2. Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidime në vende vakante për Gjykatën Kushtetuese dhe atë të Inspektorit të lartë të Drejtësisë.*

#### **Marrin pjesë:**

- |                       |                      |
|-----------------------|----------------------|
| 1. Ardian Dvorani     | (kryetar)            |
| 2. Vitore Tusha       | (zëvendës kryetare)  |
| 3. Arta Marku         | (anëtare)            |
| 4. Fatri Islamaj      | (anëtar)             |
| 5. Margarita Buhali   | (anëtare)            |
| 6. Eriol Roshi        | (anëtar)             |
| 7. Fatjona Memcaj     | (anëtar)             |
| 8. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |

#### **Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Erinda Ballanca, Avokati i Popullit.

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :**

2. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
3. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit

**Në pjesën e parë të mbledhjes, për Pikën 1 të Rendit të Ditës, marrin pjesë, si të ftuar, edhe përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED:**

1. Agnes Bernard, shefe e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, eksperte e EURALIUS.
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

## **HAPET MBLEDHJA**

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

*Ardian Dvorani* lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*Diskutimi në parim mbi Metodologjinë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese.*

*Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidime në vende vakante për Gjykatën Kushtetuese dhe atë të Inspektorit të lartë të Drejtësisë.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

*Anëtarët e Këshillit* miratojnë rendin e ditës së programuar.

*Këshilli vijon mbledhjen* me diskutimin e pikës së parë të rendit të ditës mbi diskutimin në parim mbi Metodologjinë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese.

*Ardian Dvorani* si relator i projektaktit, duke pasur parasysh edhe detyrat e lëna nga mbledhjet e mëparshme, pasi parashtron shkurtimisht punën e bërë, përpara se anëtarët të diskutojnë në parim dhe çështje kryesore të projektit, meqenëse për përgatitjen e kësaj Metodologjie është punuar së bashku me Euralius, pasi merr miratimin e anëtarëve, i kërkon *Agnes Bernhard* të bëjë një parashtrim mbi punën e bërë dhe për ecurinë e mëtejshme të diskutimit drejt miratimit të këtyre projektakteve.

*Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja)*, mbi kërkesën e anëtarëve të Këshillit për të dhënë mendime, merr fjalën dhe parashtron se jemi përpjekur që ta hartojmë këtë metodologji

bazuar në skemën të vlerësimit dhe të pikëzimit dhe mbështetur gjithashtu edhe në diskutimet që ka pasur Këshilli për këtë çështje. Pra, jemi përpjekur që ta paraqesim në mënyrë narrative mënyrën e vlerësimit dhe fushën e veprimit sipas kategorive përkatëse. Kemi hedhur propozimet tona por në aspektet e pikëzimit i mbetet Këshillit të diskutoj më tej për detajet dhe diskutuar këto propozime me avantazhet dhe disavantazhet e veta. Edhe në brendshmi kemi pasur diskutime të gjata përse i përket avantazheve dhe disavantazheve në këtë vlerësim. Më konkretisht tek kategoria e parë e meritave profesionale dhe për secilin nga kriteret jemi përpjekur të përcaktojmë % e proporcionit dhe fushën e veprimit. P.sh., në rastin e vjetërsisë në profesion kemi argumentuar fillimisht se përse do të jetë vjetërsia në punë si një nga kriteret. Gjithashtu kemi marrë në konsideratë edhe standardet ndërkombëtare pra që nuk duhet të jetë vetëm vjetërsia në punë si një nga kriteret bazë në vlerësimin e përgjithshëm. Në lidhje me këtë kemi bërë edhe një tabelë ku jepen nivelet e vlerësimit sipas vjetërsisë në punë. Megjithatë mbetet për tu diskutuar hapësira që kemi lënë brenda secilës kategori të viteve të eksperiencës. Gjithashtu është parë si me vend që sipas parashikimit të Kushtetutës dhe ligjit për kriteret që duhet të plotësoj kandidati, përtej 15 viteve bazë të eksperiencës, sa më shumë vite eksperiencë të ketë kandidati aq më shumë pikë do të marrë, duke krijuar një hapësirë prej 5 vitesh.

Për sa i përket formimit arsimor është parë si kriter ose si nivel vlerësimi që kandidatët duhet të kenë të paktën studimet e nivelit master. Këtij kriteri vlerësimi i janë dhënë 2 pikë. 1 pikë jepet kur kandidati ka marrë notën mesatare për studimet master mbi 9 ose një vlerësim ekuivalent të nivelit të 9, ndërsa 1 pikë tjetër shtesë nëse kandidati ka marrë diplomën në një nga vendet e OECD. Por kjo mbetet ende për tu diskutuar.

Për sa i përket trajnimeve pasuniversitare jepen pikët shtesë për çdo studim tjetër ose trajnim që është ndjekur pas studimeve master. P.sh. mund të jetë rasti i studimeve të mëtejshme për arritjen e titujve shkencor dhe akademikë ose përfundimi i Shkollës së Magjistraturës apo çdo studimi tjetër për formim profesional por pas nivelit master. Për çdo titull kemi dhënë edhe pikët përkatëse. Numri i pikëve varion sipas titujve të marrë. P.sh. 1 pikë është rasti i titullit asistent profesor, 2 pikë për titullin profesor, domethënë i shtohet 1 pikë për pikëshit të parë. 1 pikë shkon për përfundimin e studimeve të Shkollës së Magjistraturës, për doktoraturën dhe 2 pikë nëse këto studime doktorale janë mbaruar në një universitet të njohur jashtë vendit. Pikët e tjera shkojnë për trajnimet e tjera shtesë. Megjithatë i mbetet Këshillit për të vlerësuar pikët që jepen për këto trajnime shtese dhe varet nga natyra e trajnimeve. P.sh. ia vlen të jepen pikë në rastin kur është bërë një trajnim i shoqëruar me certifikatë, jo thjesht si tregues i pjesëmarrjes në trajnim, por certifikatë e cila ka edhe një vlerësim të performancës së kandidatit gjatë këtij trajnimi. Gjithashtu pikët mund

të jepen duke pasur parasysh edhe reputacionin e institucionit ku janë ndjekur trajnimet, p.sh nëse është një institucion jashtë vendit i njohur apo është një institut më pak i njohur. Po kështu pikët mund të jepen edhe në varësi të tematikës që është ndjekur gjatë trajnimit.

Në lidhje me gjuhët e huaja propozojmë që të angazhohet një ekspert i cili është i familjarizuar me përdorimin e kuadrit të përbashkët evropian të referencës për gjuhët dhe që përdoret si standard për kategorizimin e njohurive ose për klasifikimin e personave për sa i përket njohurive të tyre në gjuhë të huaja. Ndoshta Këshilli mund të fokusohet më shumë tek njohuritë e gjuhës angleze dhe frënge, duke qenë se janë edhe dy gjuhët bazë e përdorimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kategoria tjetër e vlerësimit është ajo e kualifikimit të përgjithshëm profesional me total 30 pikë. Këtu sugjerojmë që të mbahet në konsideratë ndarja ndërmjet vlerësimit sasior dhe vlerësimit cilësor. Sugjerojmë që të jenë 5 pikë për vlerësimin sasior dhe 25 pikë vlerësimit cilësor. Sasia është pak e vështirë për tu përcaktuar dhe vlerësuar sipas profileve të kandidatëve. Kandidati mund të paraqesë një listë të gjatë me pjesëmarrje në konferenca të ndryshme apo edhe me botimet e veta, por që mundet të mos jenë pjesë e botimeve shkencore. Në lidhje me aspektin sasior duhet të merret në konsideratë një mesatare e përgjithshme e punës së bërë dhe e ngarkesës së çështjeve që kanë mbuluar kandidatët. Gjithashtu kemi paraqitur edhe kategorizimi të tipologjisë së punës të bërë nga kandidati. Mbi këtë tipologji, sa më i madh të jetë numri i dokumenteve ose i çështjeve konkrete që ka mbuluar kandidati, ndoshta Këshilli do ta vlerësoj me vend që ti japi edhe më shumë pikë kandidatit.

Ndërsa tek vlerësimi cilësor jemi përpjekur të shpjegojmë treguesit, indikatorët, të cilët janë nënvizuar edhe gjatë diskutimeve të mëparshme në Këshill. Fillimisht Këshilli shikon për origjinalitetin dhe/ose impaktin. Këtu Këshilli mund të vlerësojë nivelin e njohurive të reja të nxjerra nga dokumentet e paraqitura nga kandidati. Me njohuri të reja kuptojmë diçka të sjellë në origjinalitet e që nuk ka qenë më përpara ose që dokumenti nuk është thjesht përmbledhje e diskutimeve apo punimeve të mëparshme. Këtu brenda vlerësohet edhe impakti që kanë sjellë ata në dokumentet e tyre. Kështu në rastin e magistratëve do të ishte sjellja e interpretimeve të reja a të ndryshme të ligjeve dhe se si kanë ndikuar ato në praktikën gjyqësore. Ndërsa tek aftësitë analitike kemi të bëjmë me aftësinë për të mbledhur informacion dhe për të ofruar zgjidhje mbështetur në argumente logjike. Metodologjia shpjegon aspektet që përkojnë me kategori të ndryshme të kandidatëve. Më pas vijojmë me kategoritë e tjera, si me aftësitë kërkimore ku jepen edhe ato aspekte ose objektiva ku mund të referohet dhe fokusohet Këshilli. Më pas kalojmë tek saktësia, precizioni dhe qartësia. Në fund paraqitet edhe një tabelë ku bëhet pikëzimi i këtyre treguesve. Aty vëmendja më e

madhe shkon për aftësitë analitike dhe kërkimore dhe më pas tek saktësia, precizoni dhe qartësia. Gjithsesi, dhe kjo është një pikë tjetër që duhet të diskutohet midis jush.

Në lidhje me Kualifikimin Shtesë Profesional fillimisht bëhet një prezantim në përgjithësi i konceptit dhe qëllimit që duhet të keni në këtë kategori. Jepet ideja dhe mesazhi që në kontekstin ideal Gjykata Kushtetuese duhet të përbëhet nga kandidatë që janë profilizuar brenda kësaj fushe dhe nga ekspertë të tjerë të lidhur me fushat e tjera të së drejtës. Për çdo kategori ekspertize jepen përshkrime të caktuara por theksi vihet tek plotësimi ose kuadri i plotë i ekspertizës në përbërje të Gjykatës Kushtetuese. Kur do të vlerësohet kandidati, në qoftë se një është ekspert në fushën kushtetuese atëherë kemi bërë referenca të ndryshme si psh. publikimet e tij, impakti që ka pasur me dokumentet e vetë, e kështu me radhë. Më pas në pikën tjetër në vijim, tek angazhimet profesionale shtesë qartësohet fakti që janë vetëm ato element ose tipare të cilët nuk janë vlerësuar më sipër e që mund të marrin një vlerësim në këtë kategori. Dhe në këtë rast si kriter vlerësimi, Këshilli mund të marrë prezantimet e bëra nga kandidatët në konferenca shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, kontribut në hartimin e legjislacionit, konsulenca etj.

Pika më e vështirë për tu vlerësuar janë meritat morale. Metodologjia përshkruan pikat më të dobëta, më të vështira dhe më sfiduese për Këshillin në vlerësimin e meritave morale. Këtu Metodologjia ka përfshirë dhe risjell edhe njeherë në vëmendje një moment që u evidentua nga një prej anëtarëve në diskutimet tona që integriteti është një cilësi që një person e ka ose nuk e ka e për tu dhënë pastaj vlerësimi vetë 18 pikë apo 0 pikë. Metodologjia parashikon edhe këtë rast të vlerësimi në rënie drastike në kuptimin e nivelit 0, në momentin kur Këshilli vlerëson mbështetur në burime të besueshme që kandidati nuk ka nivelin e meritave morale. Më konkretisht pastaj kalohet tek integriteti etik dhe moral ku Metodologjia është mbështetur tek parimet e ENCJ-së për etikën gjyqësore dhe në kuadër të saj është ndërtuar edhe një skemë e mbështetur në disa pyetje të cilat duhet të jenë në konsideratë nga Këshilli në momentin e vlerësimit të një kandidati. Mbështetur në parimet e ENCJ-së, metodologjia sugjeron 2 nënndarje që shkojnë për detyrën e ndershmërisë dhe detyrën e dinjitetit, të cilat mund të japin ndihmë në vlerësim sepse aty jepen disa orientime.

Reputacioni është një aspekt tjetër shumë i vështirë për tu vlerësuar dhe që paraqet një lloj sfide sepse këtu kemi në konsideratë karaktere të ndryshme të personaliteteve të kandidatëve. Mund të kemi rastin e personaliteteve të hapur që janë aktivist më të njohur në grupin e tyre profesional, ndërkohë që ka edhe personalitete të tjerë që janë më të mbyllur, më të tërhequr dhe nuk janë aq të dukshëm në aktivitetet e tyre. Duhet të kemi parasysh këtu edhe popullaritetin e kandidatit i cili mund të vij edhe në mënyrë rastësore. Mund të jetë rasti i një gjyqtari i cili është bërë i njohur sepse ai ka mbuluar një çështje e cila ka qenë

mediatikisht e njohur. Por kjo duhet të ketë parasysh sepse jo domosdoshmërisht ky është një nivel vlerësimi për kandidatët. Metodologjia sugjeron që Këshilli të bëjë kujdes në rastin e këtyre personaliteteve për të mos vendosur një kandidat përpara një tjetri thjesht për këto rastet rastësore që përmendëm. Vlerësimi i reputacionit të mbështetet në integritet dhe në profesionalizëm por tek reputacioni nuk vlerësohen ato elemente të cilët janë vlerësuar me sipër pikërisht tek integriteti dhe profesionalizmi. Duhet të keni parasysh që reputacioni vlerësohet edhe mbështetur tek perceptimi dhe jo thjesht tek performanca. Kandidati mund të ketë pasur një performancë të jashtëzakonshme shumë të mirë por thjesht nuk është bërë i njohur dhe nuk i njihet. Metodologjia ka disa pyetje të cilat mund të jenë ndihmë për Këshillin gjatë vlerësimit të reputacionit dhe kryesisht ato janë mbështetur tek dokumenti i ENCJ-së.

Tek kategoria tjetër, angazhimi në ndjekje të shoqërisë civile, jemi mbështetur gjerësisht tek diskutimet që janë bërë në Këshill dhe në këtë aspekt i mbetet Këshillit të vlerësojë sipas angazhimeve të kandidatit.

Më pas kemi kategorinë e fundit, të cilat janë meritat organizative dhe menaxheriale. Në këtë kategori është parë me vend të vlerësohet programi dhe vizioni, pra nëse kandidati e kupton rolin e tij si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe së dyti, vlerësohet nëse kandidati i kupton, i percepton sfidat kryesore me të cilat përballet Gjykata Kushtetuese. Tek aftësitë vendimmarrëse si normë vlerësuese është marrë fakti nëse kandidati ka pasur eksperiencë lidhësi, drejtuese ose pozicione vendimmarrëse. Tek aftësitë e komunikimit e të përfaqësimit publik edhe intervista me kandidatin duhet të ishte ndihmë për të vlerësuar nëse kandidati shprehet në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jo sfiduese. Në kategorinë e fundit, puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore, e cila vlerësohet me 1 pikë, Këshilli sugjerohet që të konsideroj ekspozimin e kandidatit ndaj një ambienti të tillë multidisiplinor. Megjithatë, në tërësi ky mbetet vetëm një dokument për tu diskutuar.

*Anëtarët e Këshillit* diskutojnë në parim dhe për disa nga çështjet kryesore që vlerësojnë në lidhje me strukturën, përmbajtjen e shpjegimeve mbi indikatorët e vlerësimit, shpërndarjen e pikëve për secilin kriter vlerësimi dhe indikator. Vlerësohet kujdesi i mëtijshëm që duhet të tregohet për të mbajtur parasysh se kjo Metodologji është një dokument me natyrë shpjeguese që bëhet publik për ta njohur çdo kandidat dhe i interesuar por nuk ka trajtën dhe një akti normues. Kjo e bën më komplekse diskutimin dhe dakordësinë për formulimet e shpjegimeve të dokumentit të paraqitur. Lidhur me kriterin vlerësues të vjetërsisë në profesion anëtarët ndajnë qëndrimin se duhet pasur parasysh si kufi për vlerësimin me pikë vjetërsia mbi 15 vjet jo vetëm si kusht kandidimi por edhe si kufi ku

fillon vlerësimi pra edhe pikëzimi. Gjithashtu, u dakordësuan që 4 pikët të shpërndahen në katër periudha kohore me 4 ose 5 vjet secila.

Lidhur me historikun arsimor anëtarët e Këshillit vlerësuan se në ndryshim nga sa sugjerohet në dokument, vlerësimi me 1 pikë të fillojë jo nga nota mesatare 9 por ashtu sikurse përcakton ligji nga nota mesatare 8, ndërsa mbi 9 me 2 pikë. Mund të diskutohet vlerësimi me 2 pikë kur nota mesatare është 8 për shkollimet jashtë vendit.

Anëtarët e Këshillit parashtruan vlerësime dhe arsyetime edhe lidhur me shpjegimin mbiu mënyrën e vlerësimit dhe të pikëzimit të kriterëve të grupuar tek Kualifikimet Pasuniversitare duke pasur parasysh shkallëzimin e titujve dhe gradave shkencore, me pikëzim ekstra kur janë fituar jashtë vendit në shkolla dhe shtete të caktuara. Diskutime dhe nevojë për reflektim në dokument ka vlerësimi dhe pikëzimi i përfundimit të Shkollës së Magjistraturës ku vlerësimi me 1 pikë të jetë proporcional krahasuar me pikëzimet e tjera, përfshirë edhe atë për trainimet afatshkurtra. Në rastin e Shkollës pikëzimi i barabartë me masterin jo i përshtatshëm kjo edhe nga fakti që mund të pranohesh aty vetëm nëse ke fituar paraprakisht master të nivelit të dytë.

Për gjuhët e huaja, anëtarët e Këshillit diskutuan dhe vlerësuan se krahas anglishtes dhe frëngjishtes si gjuhë punë të GJEDNJ duhet të përfshihen edhe tre gjuhët e të tjera në vlerësim sipas përcaktimeve të nenit 78/3 të ligjit për Arsimin e Lartë.

Tek kategoria e Kualifikimit të Përgjithshëm diskutuan dhe u dakordësuan që përmbajtja e dokumentit të përmirësohet në drejtim të shpërndarjes së pikëve bazuar në indikatorët përkatës të origjinalitetit, impaktit, aftësisë kërkimore, qartësisë etj. Në vlerësimin e rastit të plagjiaturave të mundshme duhet të mbahet parasysh diferenca sipas profilit profesional të kandidatit dhe llojit të dokumentit profesional, ku p.sh në vendimet gjyqësore përdorimi i arsytimeve që bazohen në trajtime profesionale të tjera mund të konsiderohet element vlerësues pozitiv.

Gjithashtu, për vlerësimin profesional dhe pikëzimin paraqitja nga kandidatët e 5 dokumenteve profesionale është e nevojshme, por jo të parashtrohet si kufizim në sjelljen e dokumenteve të tjera. Në lidhje me vlerësimin profesional sasior të shikohet mundësia e kërkimit të informacioneve lidhur me sasinë e punës së kandidatëve, ndoshta në 5 vitet e fundit. Sasia tregon edhe vlera, është një nga treguesit që mat punën e suksesshme në çdo profil profesional.

Anëtarët dakordësohen me shpjegimet në Metodologji për mënyrën e vlerësimit dhe pikëzimit të elementëve të meritave morale, por nevojitet më shumë kujdes në shpjegimet, burimet dhe indikatorët e vlerësimit.

**Erinda Ballanca** kërkon fjalën dhe parashtron se diskutimi i çështjes së plagjaturës ka një impakt shumë të madh publik. Ky Këshill do të kalojë kandidatë të caktuar të cilët më pas mund të evidentohen me problematika plagjature. Nuk e di se në cilin prej dokumenteve duhet ta trajtojmë. Unë jam shumë dakort që plagjaturën në doktoraturë ndoshta nuk duhet ta keni fare në këtë pikë. Po flasim për përdorim në vendime gjyqësore apo në veprimtari në punë juridike. Në këtë pikë ka një koncept komplet tjetër çështja e plagjaturës. Ky mund të jetë një problematikë sepse jo domosdoshmërisht bëhet një referencë e saktë, në kuptimin e përcaktuar siç duhet në doktoraturë. Duhet ta kemi parasysh nëse një gjyqtar apo avokat përdor në dokumentet e veta këto lloj të dhënash të konsoliduara nga ajo që është doktrina, jurisprudenca dhe kjo është gjë e mirë, nuk është gjë e keqe. Meqenëse kjo është metodologji ndoshta duhet bërë një shënim pak më i qartë që Këshilli vlerësimin e ka në lidhje me burime të këtij lloji. P.sh. në institucionin tonë kohën e fundit është emëruar komisioneri, që është pedagoge. Nisur nga mënyra e vazhdueshme e të punuarit të saj si pedagoge, një nga gjërat që më pyeti kur përgatitej një rekomandim ishte se si i specifikonim referencat në rekomandimet tona. Ajo këtë e ka pjesë të punës, të kemi referenca në bërjen e rekomandimeve apo të raporteve të posaçme që i dërgojmë Kuvendit. Prandaj ndoshta nevojitet një shënim shpjegues që të trajtojë se cili është qëllimi për të cilin e përdorimin këtë element vlerësimi.

Ndaj gjithashtu edhe mendimet për sa i përket vlerësimit të eksperiencës, por edhe për natyrën e kësaj Metodologjie që nuk duhet të jetë një akt detyrues në lidhje me vlerësimin por është një udhëzues. Duhet sqaruar se ky shërben si udhërrëfyes në kuadër të vlerësimit pasi mund të ndodh në raste praktike që këto numra po të mblidhen do të nxirrin kandidat më të keq sesa kandidatë më të mirë. Edhe mund të ndodhë teorikisht. P.sh. Shkolla e Magjistraturës është konsideruar kualifikim më se i mjaftueshëm për të bërë profesionin e gjyqtarit, i cili ka edhe vite të tëra pune duke dhënë vendime, si detyra e tij funksionale. Ndaj edhe nuk ka pse një person i cili ka pasur detyrë komplet tjetër funksionale të detyrohet të bëjë doktoratura apo tituj shkencor që të vlerësohet më shumë se sa një person i cili i bën këto sepse e ka punën e tij. Kur gjyqtari ka bërë maksimumin në profesionin e tij ndoshta e ka pasur të pamundur praktikisht bërjen edhe të doktoraturës sepse për ta do të ishte një përgjegjësi dhe një lodhje 10 herë më e madhe sesa për një pedagog. Pra duhet të mundohemi për ti dhënë më tepër vëmendje realitetit shqiptar. Në Shqipëri u bënë në një moment të caktuar shumë doktoratura krahasuar me më përpara. Ato mund të kenë qenë origjinale por shumë herë më të dobta. Unë nuk e kam aty. E kam më tepër tek fakti që këto elementë ti përqasim me realitetin shqiptar dhe që Këshilli të zgjedhë kandidaturat më të mira të mundshme për t'ia propozuar organeve të emërtesës.



**Mimoza Arbi** kërkon fjalën dhe parashtron se ajo që më shqetëson është zbatimi praktik i këtyre indikatorëve. Tek kualifikimi i përgjithshëm profesional flitet për produktin mesatar po kush do ta përcaktoj se kush është produkti mesatar. Një aspekt tjetër që sjell vështirësi edhe në vlerësim është se i kërkohet kandidatit të sjellë 5 dokumente. Por a mundet që me këto 5 dokumente të bëhet vlerësimi i të gjithë këtyre indikatorëve të vlerësimit si aftësi analitike, aftësi kërkimore, saktësia dhe preçizioni apo qartësia? Ato mund të mos gjenden bashkë në këto 5 dokumente. Në rastin e plagjaturës mendoj se nuk duhet të përfshihet fare nga Këshilli sepse nuk kemi akoma një rregull ligjor se cila do të quhet plagjaturë. Kështu që përderisa kandidati sjell një dokument që ai vërteton se ka mbrojtur një doktoraturë apo është asistent profesor nuk është KED që do ti hyjë verifikimit është plagjaturë apo jo. Do ta marrë të mirëqenë atë sipas kriterëve apo dokumentacionit zyrtar që vjen. Mund të ankohen se mbi çfarë kriteri ma ke vlerësuar që është plagjaturë. Plagjatura nuk është se lejohet por akoma nuk ka një rregullim ligjor se kush do të quhet plagjaturë. Ndërsa për çështjet e tjera që ngritën jam dakord me pjesën më të madhe të diskutimeve. Ka nevojë për tu riparë më tej edhe mënyra e pikëzimit apo vlerësimit të kandidatëve.

**Agnes Bernhard** (*përkthen përkthyesja*), kërkon fjalën dhe parashtron se nevojitet të sqarohen dy pika më të rëndësishme për çështjen e plagjaturës. Për aq kohë sa burimi nga është marrë informacioni në një punim është deklaruar dhe referohet në fund të referencave apo mënyra të tjera nga është marrë në këtë rast nuk konsiderohet si plagjaturë. Një punë kërkimore patjetër që do të ketë referenca burimore diku tjetër. Megjithatë, mbetet përsëri pikëpyetja nëse është i kopjuar apo jo materiali sepse mundet të vij një informacion që kallëzon se ky material që kandidati e ka paraqitur si të tijin më përket mua. Elementi i dytë ka të bëjë me indikatorët, me mënyrën sesi janë shpërndarë ato dhe vlerësimin e tyre në kategoritë përkatëse. Theksi tek Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional vendoset në 5 pikat kryesore. Në Metodologji ju shpjegoni se si janë bërë këto dhe ndonjëherë, për të shmangur mbivendosje ose përsëritjen e indikatorëve të përmendur në Vendim, ne e kemi përmbledhur në këto 5 kategori. Por kjo nuk do të thotë që janë neglizhuar ose janë hequr indikatorët. Gjithashtu tek çështja e pikëzimit alternativ është e rëndësishme të sqarojmë faktin që Metodologjia nuk synon që të jetë shumë e ngushtë dhe shumë precize në dhënien e pikëve sepse asnjëherë situatat nuk janë të ngrira dhe njëlloj të unifikuara. Patjetër që ne duhet të kemi një standard në vlerësimin tonë por situatat në jetë janë të ndryshme dhe këtu duhet të kemi pak hapësirë për vlerësimet sipas rrethanave konkrete për të bërë një vlerësim të duhur.

**Bledar Dervishaj** kërkon fjalën dhe parashtron se kam pasur kohë ta shikoj këtë dokument edhe sinqerisht të gjithë anëtarët e Këshillit e falënderuan EURALIUS-in. Po ashtu edhe Avokati i Popullit dhe Kuvendi. Duhet ta falënderojmë edhe ne si Institucion i

Presidentit, Agnesin personalisht dhe Julindën sepse shikoj që është punuar nga këto dy ekspertë ky dokument. Ky është dokument që në përmbajtje është i mirë. Ky dokument do tu shërbej anëtarëve të Këshillit si një udhërrëfyes nëpërmjet të cilit do të plotësojnë bindjen e brendshme kur ti vendosin pikët secilit kandidat, në mënyrë të mëvetshme. Ana subjektive do të reflektohet nëpërmjet kësaj rruge. Dhe kjo është një gjë e vështirë. Sinqerisht një nga dokumentet më të vështirë që Këshilli do të diskutojë dhe do të reflektojë, besoj unë, në mbledhjen tjetër të gjithë qëndrimet e anëtarëve të Këshillit. Sepse në momentin kur ky dokument lexohet e para që bën çdo qenie njerëzore e krahason me veten, pikëzimin. Po të shikojmë të gjithë fashën e konkurrentëve, që tashmë është publikuar, kemi magjistratë, jo magjistratë, avokat, lektor, këshilltar. Fasha është e ndryshme. Po të krahasojmë modelin e indikatorëve që secili nga këta ka në jetën e vetë, është komplet ndryshe. Indikatorët për të vlerësuar kriterin moral janë ndryshe tek një avokat, që jetën e ka të lirë pasdite dhe ndryshe tek një gjyqtar dhe prokuror. Kështu që është shumë vështirësi e madhe. Mua më pëlqeu që ju ndërhytë tek tabelat e eksperiencës të viteve në punë. Përderisa është 15 vjet është një kusht dhe në momentin që e plotëson kushtin pse jo edhe kriterin për të marrë një pikë. Edhe tek pjesa e notës mesatare, unë e gjej me vend propozimin e kryetarit. Do ti sjell me shkrim mendimet për secilën nga këto pjesë të formulimit. Tek pjesa morale, e kam thënë edhe herë të tjera, do ti mëshoja më shumë që të gjendet më shumë arsyetim dhe vend tek pjesa e intervistës së kandidatit me anëtarët e Këshillit. Për sa i përket indikatorëve, për të vlerësuar kriterin moral, Këshilli mund ti referohet edhe atyre fakteve që vjen në dijeni nga vetë investigimi i tij apo dhe nga ato që mund të ketë sjellë publiku. Kurse pyetjet në adresë të kandidatit dhe tregimi apo deklarimi përpara Këshillit mund të tregoj shumë për një kriter moral të shëndoshë apo për tu vlerësuar me 0. Megjithatë, unë për secilën nga këto, si të gjithë anëtarët do të sjell ndonjë koment.

***Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani***, pasi merr mendimin e anëtarëve dhe dakordësinë që përpara mbledhjes së ardhshme, të gjithë anëtarët dhe pjesëmarrësit të përgatisin dhe shkëmbejnë mendimet dhe sugjerimet e tyre me shkrim lidhur me përmbajtjen e Metodologjisë, njofton se do të ketë një pushim të shkurtër, për të vijuar më pas me çështjet që i përkasin pikës së dytë të rendit të ditës.

***Këshilli*** ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër

## **PJESA E DYTË E MBLEDHJES.**

***Mbledhja e Këshillit***, pas pushimit, vijon me shqyrtimin dhe vendimmarrjen për rastet e tërheqjes nga kandidimi të disa kandidatëve që kanë shprehur interesin për kandidim në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Alban Brati.

**Arta Marku**, parashtron relatimin për kandidatin Alban Brati për vendin vakant të shpallur nga Presidenti në datën 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca** sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se qartësisht kandidati ka shprehur vullnetin për të hequr dorë. Nga pikëpamja formale z.Brati mund të kishte ushtruar pak më shumë kujdes e të hidhte emër mbiemër firmë dhe jo vetme firmë por mendoj se është dokument i mjaftueshëm ku gjithsesi ai ka deklaruar vullnetin e tij.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Bashkim Nikolla.

**Eriol Roshi** parashtron relatimin për kandidatin Bashkim Nikolla për vendin vakant plotësues të shpallur nga Presidenti në datën 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se nuk kam asnjë koment tjetër të ndryshëm nga rasti i parë.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Çlirim Gjata.

**Vitore Tusha** parashtron relatimin për kandidatin Çlirim Gjata për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se vullneti është i qartë dhe besoj se jemi në kushtet të përcaktuara nga ligji, qoftë nga relacioni, qoftë nga vendimi.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Dashmir Kore.

**Vitore Tusha** parashtron relatimin për kandidatin Dashmir Kore për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Erinda Ballanca*, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtrohet se vullneti është i qartë, i bërë sipas ligjit. Edhe procedura duket e rregullt, kështu që vendimi më duket i drejtë.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Ilir Panda.

*Arta Marku* parashtrohet relativisht për kandidatin Ilir Panda për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Erinda Ballanca*, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtrohet se me të njëjtën keqardhje konstatoj, si kandidaturat e mëparshme, që jemi para përfundimit të procesit të verifikimit për shkak të vullnetit të shprehur nga ana e kandidatit.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Ilir Kadiu.

*Vitore Tusha* parashtrohet relativisht për kandidatin Ilir Kadiu për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Erinda Ballanca* shtron pyetjen nuk ka për këtë kandidat asnjë komunikim përveç këtij komunikimi me email? Sepse është një adresë në hotmail dhe nuk pashë asnjë firmë.

*Ardian Dvorani* përgjigjet se nga dokumentacioni del që njoftimin e ka dërguar me email, krahas veprimeve për komunikime me telefona për të qene të sigurte për adresat që kane lënë.

*Erinda Ballanca*, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtrohet se duke besuar në verifikimin e tyre nuk shikon problem tjetër.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Ilir Panda.

*Vitore Tusha* parashtrohet relativisht për kandidatin Ilir Panda për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se vullneti është i qartë për tërheqjen nga kandidimi.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Ilir Panda.

**Eriol Roshi** parashtron relatimin për kandidatin Ilir Panda për vendin vakant plotësues të shpallur nga Presidenti në datën 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se kam të njëjtin mendim si në kandidimet e tjera. Z. Panda ka bërë njoftim për secilin pozicion, për secilën emërtësë veç e veç kështu që vullneti është i qartë për tu tërhequr.

**Ardian Dvorani** relaton rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Ilir Panda për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca** sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se vullneti është i qartë për tërheqjen nga ky kandidim.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Irena Nino.

**Vitore Tusha** parashtron relatimin për kandidates Irena Nino për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se duket që njoftimi është marre në sekretari dhe ka vulën e sekretarisë, ka emër mbiemër firmë dhe është i rregullt komunikimi.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Fatjona Memçaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Mitat Dautaj.

**Fatjona Memçaj** parashtron relatimin për kandidatin Mitat Dautaj për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtrohet se relacioni është i qartë, dokumentacioni tregon vullnet të shprehur në lidhje me faktin e ndërprerjes të kësaj procedurë apo dorëheqjen e kandidimit e cila passjell ndërprerjen e procedurës së verifikimit për këtë kandidat.

**Ardian Dvorani** relaton rastin tjetër të kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari për vendin vakant plotësues për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 24.12.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca** sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtrohet se vëren se do të vazhdojë që të jetë për dy vakancat e tjera. Vullneti është i qartë për tërheqjen nga ky kandidim. Rezulton që qoftë formalisht qoftë nga ana dokumentare është shprehur në mënyrë të plotë dhe vendimmarrja juaj dhe relacioni është i saktë dhe në përputhje me procedurën.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Shpresa Beçaj.

**Vitore Tusha** parashtrohet relatimin për kandidatën Shpresa Beçaj për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtrohet se për sa i përket vullnetit të znj. Beçaj dhe për shkaqet që ajo jep dorëheqjen, mendoj se procedura është e plotë dhe jemi përpara vendimmarrjes së ndërprerjes së procedurës së kandidimit.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Sokol Hasani.

**Vitore Tusha** parashtrohet relatimin për kandidatit Sokol Hasani për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtrohet se e lexova dhe pata minutat e duhura për ta lexuar këtë email të z. Hasani. Nuk është hera e parë dhe është e njohur gjuha e përdorur prej tij dhe për hir të së vërtetës rezulton qartë se zotëria nuk kërkon të bëhet pjese e

shqyrtimit pranë këtij organi të kandidaturave, çfarë do të thotë që është tërhequr nga kjo procedure pavarësisht nga ato shkaqe për të cilat ai pretendon se e kanë çuar në këtë vendimarrje. Kështu që pavarësisht shkaqeve, unë në cilësinë e Avokatit të Popullit konsideroj proceduralisht që kandidatura e tij nuk mund të vazhdojë shqyrtimin për shkak të vullnetit të shprehur dhe duhet të ndërpritet procesi i vlerësimit.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Lefteri Leshi Luzi për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Margarita Buhali** parashtron relatimin për kandidaten Lefterie Leshi Luzi për Inspektore të Lartë të Drejtësisë.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se relacioni ishte shumë i qartë, vullneti është gjithashtu i qartë dhe më tepër për përkujdesjen që ju keni bërë për të komunikuar me të në mënyrë telefonike. Mendoj se vendimi për ndërprerjen e vlerësimit është i drejtë.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Suzana Frashëri për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Margarita Buhali** parashtron relatimin për kandidaten Suzana Frashëri për Inspektore të Lartë të Drejtësisë.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se KED ka bërë maksimalisht që ti jepte mundësinë kandidatëve që të vazhdonin me këtë procedurë nëse ishte e mundur për sa kohe nuk ishte ndonjë problem teknik. Kështu që mendoj se vendimi për ndërprerjen është i drejtë dhe vullneti shprehur prej saj është i qartë.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaroi mbylljen e mbledhjes.

## **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 15.57**

**Sekretare**

**Kryetari**

**Dorina DULAJ**

**Ardian DVORANI**

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal.  
Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.